



TENDER

Çmimi Kaiser Maximilian për shërbimin evropian në nivel rajonal dhe komunal 2021

Landi i Tirolit dhe qyteti Innsbruck, me rastin e datëlindjes së 85-të të Kryetarit të Bashkisë së qytetit Innsbruck prej shumë vitesh dhe presidentit të Këshillit të Landit, Dr. Alois Lugger (†), me mirënjohje për shërbimin e tij në Evropë, akorduan për herë të parë çmimin Kaiser Maximilian në vitin 1997, një çmim evropian për politikën rajonale dhe komunale të landit të Tirolit dhe qytetit të Innsbruck.

Në kuadër të përgatitjeve për vitin 2019, si vit përkujtimor të Kaiser Maximilian, landi i Tirolit dhe qyteti i Innsbruck kanë rikonceptuar çmimin Innsbruck Kaiser Maximilian.

Me dhënien e këtij çmimi, synohet të nderohen projekte të veçanta të personaliteteve, institucioneve apo organizatave, nëpërmjet të cilave synohet një vlerë e shtuar evropiane, në nivel rajonal dhe/ose komune. Aplikantët për këtë projekt duhet të jenë të besueshëm dhe në gjendje që ta zbatojnë dhe ta përfundojnë projektin.

Më tepër vëmendje do të marrin projektet të cilët japin një kontribut të veçantë në harmoninë, integrimin, bashkekzistencën në paqe dhe solidaritetin në Evropë. Duhet të pasqyrohet lidhja me nivelet komunale dhe rajonale. Projektet e dorëzuara duhet të ofrojnë edhe mundësinë për të nxjerrë “best practices” (praktikat më të mira), të cilat do të mund të përçohen më pas si të tilla, edhe në komunat dhe rajonet e tjera.

Nëpërmjet një pune të madhe në fushën e marrëdhënieve me publikun, synohet të përforcohet mendimi për Evropën mes qytetarëve dhe qytetareve. Projekti nuk lejohet të ketë qëllim fitimin apo arritjen e avantazheve pasurore, ose të jetë në kundërshtim me parimet e përgjithshme të së drejtës evropiane.

Projektet e dorëzuara duhet të kenë një orientim inovator, të funksionojnë me metoda të reja organizimi, si dhe të përmbajnë një vlerësim të efekteve e zhvillimeve, për sa i përket qëllimeve të projektit dhe efekteve të pritshme. Një rëndësi parësore kanë këtu aspektet e larmishme të integritit evropian. Kriteria vendimtare janë ndikueshmëria e projektit, qëndrueshmëria dhe kreativiteti, si dhe fokusimi në tërheqjen e grupeve të tjera të interesit, duke i bërë që të angazhohen në çështjet evropiane.

Çmimet Kaiser Maximilian jepen çdo dy vite. Çmimi konsiston në një certifikate, një medalje (medaljoni i Perandorit Maximilian I, v. 1509) dhe një shumë parash prej 10.000,- Euro. Çmimi në para është i rezervuar për projektin më të mirë. Çmimi do t'i jepet një personaliteti, një institucioni apo organizate me angazhim evropian, në nivel rajonal dhe komunal.

Projektet mund të dorëzohen vetëm online, nëpërmjet një platforme të integruar aplikimi në faqen www.kaiserm Maximilianpreis.at. Projektet duhet të dorëzohen në gjuhën gjermane, franceze ose angleze.